ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNAL OBILIQ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 614-26-8002-2-3-6.

Sa i përket tenderit për: "Shërbimet e bufesë për Komunën e Obiliqit".

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ _____ OE "System Bar ESS SH.P.K."_____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

___ **Rr. " Hasan Prishtina 286, 15000, Obiliq, Kosovë'' ___**
(Adresa)

_____**OBILIQ**_____ ____**10000**____
(Vendi) *(Kodi postar)*

_____**+383 48 48 48 98**____ _____ ***812458827***_____
(Numri i telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_____ **Kushtim Sallova**_____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____**sallovakushtrim@gmail.com**_____
(Adresa elektronike)



___**05.11.2026**___
Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkëngjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faksit)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënien të kontratës]:

Njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e bufesë për Komunën e Obiliqit", me numër prokurimi 614-26-8002-2-3-6, është publikuar më datë 21.09.2026, ndërsa hapja e ofertave është bërë më datë 28.09.2026. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomikë. Kriteri kryesor për dhënien e kontratës ka qenë çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒ X

Hapja e tenderëve është bërë më datë 28.09.2026.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [**X**] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet deri në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së,
AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,
AK ka shkelur nenin 4 të RRPP-001/2022,
AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së.
AK ka shkelur nenin 17 të RRPP-001/2022,
AK ka shkelur nenin 71 të LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rreme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës suaj.

Pretendimi nr 1: ka te beje me mangsit e operatorit ekonomik ‘’**Leonor Pllana B.I.**,’’, si me posht.

Nga procesverbali i hapjes së ofertave rezulton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka deklaruar vlerën prej 5,300.00 € si në kolonën e çmimit, ashtu edhe në kolonën e çmimit me të gjitha taksat, pa paraqitur dallim ndërmjet këtyre dy vlerave dhe pa e bërë të qartë nëse TVSH-ja është përfshirë në çmimin e ofertuar. Në anën tjetër, oferta e operatorit ekonomik të pasuksesshëm përmban veçmas çmimin pa TVSH dhe çmimin me TVSH, sipas ofertës së dorëzuar. Përkundër kësaj mospërputhjeje në ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë, Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar atë për dhënie të kontratës, pa sqaruar mjaftueshëm se si është konstatuar përputhshmëria e ofertës me kërkesat e detyrueshme të dosjes së tenderit. Kjo ngre dyshime lidhur me zbatimin e njëtrajtshëm të kërkesave të prokurimit publik.
Sepse kur cmimit të operatorit Pretendent për Kontrat po ti vendoset dhe tvsh-ja sipas rregullav del të jetë cmimi më i lartë i ofertës 6,254.00 pra cmimi tejkalon ofertën time të përgjegjshme ku une jamë me çmim prej: 6,110.00, dhe diferenca është: 144 euro më i shtrejnjët.
Në anën tjetër, oferta e operatorit ekonomik të pasuksesshëm ka përmbajtur vlerat e deklaruara veçmas, përkatësisht çmimin pa TVSH dhe çmimin me TVSH, sipas ofertës së dorëzuar.

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	**614-26-8002-2-3-6**	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	**Shërbimet e byfes për Komunën e Obiliqit**
Numri i brendshëm Internal No Interni broj			

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
28.09.2026	**28.09.2026, 10:00:00**	**28.09.2026, 10:00:00**	**Komuna e Obiliqit-kati i II-të salla për hapjen e ofertave**	**2**

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Supplement/Amendment Dopuna/izmjena
1.	**Leonor Pllana B.I., Rr.Washington, Nr.64, 15000, Obiliq**	**123**	**Shërbimet e byfes për Komunën e Obiliqit**	**PO**	**5300.00**	**5300.00**	**JO**
2.	**System Bar ESS SH.P.K., Hasan Prishtina 286, 15000, Obiliq**	**614-26-8002-2-3-6**	**Shërbimet e byfes për Komunën e Obiliqit**	**PO**	**5010.20**	**6110.00**	**JO**

Përkundër kësaj mospërputhjeje në ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë, Autoriteti Kontraktues ka vendosur që ta rekomandojë të njëjtin për dhënie të kontratës, pa sqaruar në mënyrë të mjaftueshme se si është konstatuar përputhshmëria e ofertës së tij me kërkesat e detyrueshme të dosjes së tenderit. Dhe ne kundershtim me ligjin eprokurimit publik te cilin nuk e ka aplikuar udheheqsi i prokurimit kk Obiliq, i cili spjegon qart se duhet e perfshihen te gjitha TAKSAT.

SHKELJA E KËRKESAVE TË DOSJES SË TENDERIT DHE NENIT 51.2 TË RRPP-SË.

Sipas nenit 36 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili rregullon procedurën e kuotimit të

çmimit, dhe nenit 51.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit se kuotimet duhet të përmbajnë një çmim fiks, duke përfshirë të gjitha tatimet dhe taksat në fuqi, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera të zbatueshme për realizimin e kontratës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues e ka përcaktuar shprehimisht këtë kërkesë edhe në paramasën dhe parallogarinë e publikuar në sistemin e-Prokurimi, përmes vërejtjes:

"Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë, duke llogaritur edhe TVSH-në."

Kjo kërkesë është pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.
Fakti se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka deklaruar të njëjtën vlerë prej 5,300.00 € në të dy kolonat e procesverbalit të hapjes së ofertave, përbën rrethanë që kërkon verifikim dhe vlerësim të arsyetuar nga Autoriteti Kontraktues, në mënyrë që të vërtetohet nëse çmimi i ofertuar është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.
Autoriteti Kontraktues nuk mund t'i anashkalojë kërkesat e përcaktuara nga vetë ai në dokumentacionin e tenderit dhe, njëkohësisht, ta rekomandojë një ofertë për kontratë.

REGJISTRIMI PËR TVSH DHE PËRGJEGJSHMËRIA E OFERTËS JANË ÇËSHTJE TË NDRYSHME.

Theksoj se kjo kërkesë për rishqyrtim nuk ka për qëllim të kontestojë qarkullimin vjetor të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe as të vërë në diskutim, në vetvete, obligimin e tij për regjistrim për TVSH sipas legjislacionit tatimor.
Edhe nëse operatori ekonomik nuk e ka arritur pragun e qarkullimit që krijon obligimin për regjistrim për TVSH, kjo rrethanë nuk e përjashton detyrimin e tij që ta paraqesë ofertën në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe kushtet e procedurës së prokurimit.
Çështja thelbësore në këtë rast është nëse operatori ekonomik e ka plotësuar ofertën në mënyrën e kërkuar dhe nëse çmimi i deklaruar përputhet me kërkesën e Autoritetit Kontraktues që në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikueshme.
Prandaj, Autoriteti Kontraktues duhet të dëshmojë se e ka trajtuar këtë çështje në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren përkatëse dhe Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, së bashku me plotësimet dhe ndryshimet e aplikueshme.

MOSPËRPUTHSHMËRIA NË VLERËSIMIN E OFERTËS DHE PARIMI I TRAJTIMIT TË BARABARTË
Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka bërë të qartë dallimin ndërmjet çmimit të ofertuar dhe çmimit me të gjitha taksat, ndonëse ky dallim është paraqitur në mënyrë të veçantë në ofertën e operatorit ekonomik të pasuksesshëm.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues duhet të sqarojë se mbi çfarë baze ligjore dhe faktike e ka konsideruar ofertën e operatorit të rekomanduar si të përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.
Nëse gjatë vlerësimit është konstatuar se oferta nuk i përmbush kërkesat e detyrueshme të dokumentacionit të tenderit, Autoriteti Kontraktues duhet të veprojë në përputhje me

dispozitat ligjore që rregullojnë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave, pa lejuar që një operator të përfitojë nga mospërputhjet që nuk do t'u toleroheshin operatorëve të tjerë.
Për rrjedhojë, kërkoj që të bëhet një shqyrtim i plotë dhe i paanshëm i dokumentacionit të ofertës së rekomanduar për kontratë, duke përfshirë formularin e ofertës, paramasën dhe parallogarinë, procesverbalin e hapjes së ofertave dhe raportin e vlerësimit të tenderëve.

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e lartcekura, kërkoj nga Autoriteti Kontraktues:

1. Ta aprovojë këtë kërkesë për rishqyrtim si të bazuar, në përputhje me dispozitat ligjore të aplikueshme.
2. Ta rishqyrtojë vendimin e datës 22.10.2026 për rekomandimin e operatorit ekonomik për kontratë.
3. Ta shqyrtojë në mënyrë të veçantë mospërputhjen ndërmjet vlerës prej 5,300.00 € të shënuar në kolonën e çmimit dhe asaj të shënuar në kolonën e çmimit me të gjitha taksat.
4. Ta verifikojë nëse oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, veçanërisht kërkesën që çmimi të përfshijë të gjitha taksat e aplikueshme.
5. Nëse konstatohet se oferta nuk i përmbush kërkesat e detyrueshme të dosjes së tenderit dhe legjislacionit në fuqi, ta trajtojë atë në përputhje me dispozitat përkatëse për ofertat e papërgjegjshme dhe të anulojë rekomandimin për dhënie të kontratës.
6. Të nxjerrë vendim të arsyetuar, duke i trajtuar në mënyrë konkrete të gjitha pretendimet e paraqitura në këtë kërkesë dhe duke specifikuar bazën ligjore dhe faktike të vendimmarrjes.

Në rast të refuzimit të kësaj kërkese, kërkoj që vendimi të përmbajë arsyetim të plotë për secilin pretendim, në mënyrë që të mund të ushtroj të drejtat e mia ligjore pranë Organeve kompetente të shqyrtimit të prokurimit publik.

Bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë që OSHP-ja t'i shqyrtojë me kujdes pretendimet tona dhe të marrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET e në tërsi si e bazuar Ankesa e OE "System Bar ESS SH.P.K.,''lidhur me tenderin "Shërbimet e bufesë për Komunën e Obiliqit" Nr. i prokurimit: 614-26-8002-2-3-6. i iniciuar nga KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT.

ANULOHET njoftimi për kontratë i AK - KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT dhe lënda të kthehet në rivlersim.

AK të angazhohet seriozisht dhe të eliminoj OPERATORIN E REKOMANDUAR PER KONTRAT I

CILI ESHTE REKOMANDUAR NE MENYT TE PA LIGJSHME DHE NE KUNDERSHTIM TE PLOT ME PROKURIMIT PUBLIK, e më pas të vazhdohet me procedurën në fjalë ne perputhje me ligjin ne fuqi të prokurimit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që mund të na shkaktohen nëse nuk veprohet në përputhje me legjislacionin në fuqi do t'ua paraqesim ekspertëve vlerësues dhe avokatit të kompanisë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkëngjitura

Bashkëngjitni kërkesës për rishqyrtim dokumentet e renditura më poshtë:

B05 Njoftim për Kontratë.
B12 Procesverbali i hapjes së tenderëve.
Njoftimi mbi vendimin e AK.
Raporti i vlerësimit Sh. Bufesë.